

FJALA E DEPUTETIT NIKO PELESHI

E HËNË 20 DHJETOR 2021

E nderuar Kryetare,

Të nderuar deputetë,

Sot miratojmë një ligj që vjen si një lajm i mirë për fëmijët, familjarët e të cilëve kanë humbur jetën në mbrojtje të pronës publike, jetës së individit apo për shkak të detyrës publike. Në mënyrë të merituar fëmijët e tyre me këtë ligj marrin statusin kuptimplotë “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”. Ky ligj forcon profilin human të shtetit dhe qeverisjes. Me këtë ligj shoqëria shpreh mirënjohje për sakrificën e virtytin dhe merr përgjegjësi për t’u përkujdesur për fëmijët e bashkëqytetarëve tanë më të mirë. Përfitues të këtij statusi janë fëmijët apo personat nën kujdestari të një personi të shpallur apo të njohur me statusin “Dëshmor i Atdheut”. Ne kemi disa ushtarakë të nderuar, të cilët kanë dhënë jetën në shërbim dhe jemi sot shumë të gëzuar që me këtë status fëmijët e tyre do të marrin përkujdesje të shtuar nga shteti. Fëmijët apo personat nën kujdestari të shtetasve shqiptarë, të cilët kanë humbur jetën në përpjekje për të ndihmuar popullsinë për mbrojtjen e pronës publike ose për shpëtimin dhe mbrojtjen e jetës së individit, janë, gjithashtu, përfitues të këtij statusi; fëmijët apo personat nën kujdestari të shtetasve shqiptarë, që kanë humbur jetën në vendin e punës si pasojë e kryerjes me përgjegjshmëri të detyrës dhe ushtrimit të profesionit në kushte apo situata që lidhen me ngjarje të jashtëzakonshme apo të fatkeqësive natyre, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi apo gjatë një akti dhune gjatë ushtrimit apo për shkak të detyrës dhe në lidhje të drejtpërdrejtë me ushtrimin e saj, janë, gjithashtu, përfitues të këtij statusi. Fëmijët përfitojnë trajtim financiar mujor deri në masën 100%, në varësi të numrit të fëmijëve (unë nuk dua të përsëris detajet që i sqaroi shumë mirë ministrja Manastirliu); përfitojnë, gjithashtu, shërbim shëndetësor falas, shkollim falas, pajisje, materiale shkollore falas, bursë të plotë nga shteti, ku fitojnë të drejtën e ndjekjes së arsimit të lartë publik, orientim profesional falas, sipas kërkesës në fund të çdo cikli arsimor, mbështetje për trajtim preferencial për punësimin e këtyre personave në administratën publike apo biznesin privat në përfundim të studimeve universitare, sipas kushteve të përcaktuara në VKM. Ky është nga ato projektligje që vetëm mund të përshëndeten e të votohen, pa dallime ngjyrash partiake. Fëmijët janë përtej ngjyrave tona.

Dallimet tona partiake nuk duken nga lartësia e Shqipërisë së fëmijëve tanë. Nëse do të arrinim ta shihnim edhe ne Shqipërinë e së nesërme nga ajo lartësi, shumë energji e harxhuar për debate të ngatërruara me interesa të së sotmes do të ishin kursyer. Unë e shoh këtë projektligj si pjesë e një vizioni shumë më të gjerë që qeveria ka për fëmijët dhe të rinjtë. Përkujdesja është pjesë e rëndësishme e këtij vizioni dhe po kaq të rëndësishme janë edhe programet e tjera që mbajnë në fokus fëmijët dhe të rinjtë. Në dy mandatet e kaluara të qeverisjes sonë është bërë një punë e pakrahasueshme për fëmijët. Janë ndërtuar shkolla të standardeve europiane, sidomos këtu në Tiranë, jo të gjitha shkollat në territorin e Shqipërisë janë të këtyre standardeve, por shkollat e ndërtuara së fundi me këto standarde e kanë vendosur lart stekën për çdo zhvillim të ri, për çdo shkollë të re që ndërtohet tani e në vazhdim në Republikën e Shqipërisë. Kemi ndërtuar infrastrukturë sportive në shkolla dhe qytete, duke filluar nga mandati i parë, si pjesë e programit të “Rilindjes urbane”. Përmbajtja e shkollës i është larguar me guxim mediokritetit. Ky është proces që vazhdon, tekstet kanë

ndryshuar kryekëput cilësisht, por puna për përsosjen e tyre, natyrisht, vazhdon. Ne në Korçë kemi ndërtuar një qytetë fëmijësh të standardeve europiane, por edhe për disa bashki qeveria në mënyrë proaktive ka hartuar projekte të ngjashme për t'u zbatuar. Ato janë aty për t'u përfaquar nga kryetarët e bashkive e për t'u kthyer në projekte apo programe në mbështetje të fëmijëve. Kemi eksperimentuar konceptin e shkollës komunitare dhe tani po kalojmë masivisht në zhvillimin e arteve dhe zejeve. Kreativiteti dhe inovacioni, si përgjigje magjike ndaj kohës së humbur e plot gabime të së shkuarës, duhet të kthehet në kulturën e re të shoqërisë, por ndryshimet kulturore marrin kohë dhe duhen filluar nga fëmijët. Kjo është një sfidë që kërkon mbështetje politike, bipartizane dhe një bashkëpunim të gjerë me komunitetin e mësuesve, prindërve dhe me gjithë shoqërinë. Përgjithësisht, përgjegjësinë për edukimin e fëmijëve dhe përgatitjen e tyre për të nesërmen ia besojmë vetëm sistemit arsimor, por kjo nuk është një çështje që i përket vetëm këtij sistemi.

Sistemi ynë arsimor duhet të marrë impulse nga gjithë shoqëria, sepse ai sistem punon për gjithë shoqërinë, punon për nëpunësit e ardhshëm të shtetit, punon për sipërmarrësit e nesërm, punon për ushtarakët e Forcave të Armatosura që do të kenë përgjegjësinë e ruajtjes së sigurisë kombëtare, punon për artistët, sportistët, shkencëtarët e së nesërmes, punon për qytetarët e Shqipërisë anëtare e BE-së. Nuk mund të pretendojmë për ushtarakë të devotshëm, për Forca të Armatosura të Republikës së Shqipërisë nëse nuk kujdesemi sot për të injektuar dashuri për vendin dhe krenari për historinë tonë. Na duhet një sistem arsimor që u krijon hapësirë fëmijëve të merren me art e të ushtrojnë zeje, që i ndihmon të zbulojnë dhuratën që u ka dhënë Zoti dhe natyra, ndaj programi i arteve dhe zejeve, që drejtohet me shumë përkushtim nga ministria e posaçme për fëmijët dhe të rinjtë, është qasja e duhur.

Duhet t'i çlirojmë fëmijët nga detyrat klasike të shtëpisë dhe ta lëmë pasditen e tyre në funksion të aktiviteteve që vijnë si nevojë e sistemeve të tjera. Duhet t'i sjellim fëmijët më pranë natyrës dhe mjedisit, më pranë punës krijuese dhe mendimit kritik dhe t'i orientojmë drejt përdorimit për mirë të teknologjisë. Ndaj gjithçka bëjmë për fëmijët, nga përkujdesja dhe masat sociale deri te evoluimi i vazhdueshëm i programit kurrikula dhe ekstrakurrikular, është investimi më i mirë për Shqipërinë. Fëmijët do të trashëgojnë pasurinë kombëtare, por do të trashëgojnë edhe gabimet tona, ndaj duhet të mendohemi dy herë kur votojmë për këtë projektligj dhe për çdo iniciativë ligjore që shkon në dobi të fëmijëve, në dobi të Shqipërisë të së nesërmes. Le ta votojmë pa dallim këtë projektligj, si minimumi i seriozitetit dhe përgjegjshmërisë për fëmijët dhe Shqipërinë. Faleminderit!